



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.7, datë 21/05/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SAKTËSIMIN E
KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES
NR.SERIE 00002, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.44, DATË
22.02.2017 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,
SUBJEKTIT “KLOSI-09” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 00002, miratuar me Vendimin Nr.44, datë 22.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X=4411792; Y=4596558; (ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X=4423784; Y=4599030; Z=240m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=507121; Y=4598498; Z= 240 m.m.n.d (KRGJSH)

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 20$ l/sek
 - Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 4$ l/sek
 - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në shtratin e lumit Mat
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 00002, miratuar me Vendimin Nr.44, datë 22.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat, “leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë teknologjik”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuar me vendodhje, Bashkia Klos, Qarku Dibër.
 3. Burimi ujqor të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.
 4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

